



Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

RAPORTI I INDIKATORËVE BAZË TË PERFORMANCËS PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË PËR PERIUDHËN: KORRIK – DHJETOR 2016

AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE TË KOSOVËS

PRILL 2017

PËRMBAJTJA

I. HYRJE.....	3
II. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE	4
III. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHPK-VE	5
IV. KOHA PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS QENDRËS SË REGJISTRIMIT	6
V. REGJISTRIMI DHE ÇREGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE	7
VI. REGJISTRIMI I DEGËVE TË KOMPANIVE TË HUAJA SIPAS VENDIT TË ORIGJINËS ..	8
VII. NUMRI I SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILAT ËSHTË I PËRFSHIRË SË PAKU NJË PRONAR, ORTAK OSE AKSIONAR I HUAJ	9
VIII. REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË	10
IX. PËRFUNDIM.....	11

I. HYRJE

Ky raport është rezultat i vlerësimit të përbashkët të kryer për gjysmën e dytë të vitit 2016 nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “ARBK”) me përkrahjen e Projektit të USAID-it Partneritetet për Zhvillim (në tekstin e mëtejshëm “USAID PFD”) të disa indikatorëve të performancës lidhur me procesin e regjistrimit të shoqërive tregtare në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe, një ekip i përbashkët i përbërë nga zyrtarët e ARBK-së dhe këshilltarët e USAID PFD kanë analizuar një sërë indikatorësh të lidhur me performancën e ARBK-së, duke përfshirë:

- Kohën për regjistrim të shoqërive tregtare në përgjithësi në Kosovë dhe për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuara në veçanti, si dhe sipas komunave;
- Numrin total të shoqërive tregtare të regjistruara sipas formës ligjore dhe sipas numrit total të shoqërive tregtare të çregjistruara sipas formës së shoqërive tregtare;
- Numrin total të degëve të kompanive të huaja të regjistruara sipas vendit të origjinës;
- Numrin e pronarëve, ortakëve ose aksionarëve të huaj të përfshirë në shoqëritë tregtare të Kosovës sipas llojit të shoqërive tregtare;
- Përqindjen e bizneseve individuale në pronësi të femrave, dhe
- Përqindjen e ortakëve ose aksionarëve sipas gjinisë në shoqëritë tregtare në Kosovë.

Projekti Partneritetet për Zhvillim, si dhe projektet e mëparshme të financuara nga USAID, kanë përkrahur në vazhdimësi MTI-në dhe ARBK-në përmes përmirësimeve ligjore, trajnimit të stafit, ngritjes së kapaciteteve dhe aktiviteteve tjera që kanë pasur për qëllim përmirësimin e procesit të regjistrimit të shoqërive tregtare.

Këto aktivitete kanë kontribuar në shkurtimin e konsiderueshëm të kohës për regjistrim të shoqërive tregtare dhe eliminimin e hapave në procesin e regjistrimit të shoqërive tregtare, siç reflektohet në Raportin e Bankës Botërore për të Bërit Biznes (“Doing Business”) ku rangimi i Kosovës është përmirësuar nga pozita e 170-të në raportin për vitin 2012 në pozitën e 13-të në botë në raportin për vitin 2017.

Me avancimin e mëtutjeshëm të procesit të regjistrimit të shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe përpjekjet për funksionalizimin e regjistrimit të plotë elektronik, pritet që numri i indikatorëve dhe cilësia e të dhënave të rriten dhe të pasqyrohen në raportet pasuese.

Ky raport analizon të dhënat e nxjerra nga regjistri i shoqërive tregtare të ARBK-së për shoqëritë tregtare që me ligje të veçanta në Kosovë kërkohen të regjistrohen në ARBK. Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, procesi i regjistrimit të shoqërive tregtare në Kosovë është akt formal, administrativ dhe informativ. Rrjedhimisht, ky raport nuk bën ndonjë supozim dhe nuk ofron shifra lidhur me shoqëritë tregtare që janë aktive dhe funksionojnë në Kosovë, mirëpo fokusohet kryesisht në matjen e efikasitetit të ARBK-së dhe qendrave komunale të regjistrimit në zhvillimin e procedurave të regjistrimit ose çregjistrimit të shoqërive tregtare.

Për të marrë një pasqyrë më të qartë të numrit, madhësisë, dhe statusit funksional të shoqërive tregtare dhe subjekteve tjera ekonomike të angazhuara në veprimtari ekonomike në Kosovë, ekziston nevoja për një përpjekje më gjithëpërfshirëse duke përfshirë institucionet tjera qeveritare, në radhë të parë Administratën Tatimore të Kosovës dhe Ministrinë e Administratës Publike.

Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe ligjeve tjera të zbatueshme, ARBK aktualisht regjistron këto forma të shoqërive tregtare: Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, Ortakëri e Kufizuar, Shoqëri

me Përgjegjësi të Kufizuar, Shoqëri Aksionare, Degë e Kompanisë së Huaj dhe Kooperativë Bujqësore.

Për qëllime të këtij raporti, ditët janë llogaritur në bazë të matjes së ditëve të punës. Me disa përjashtime kur matjet janë bërë për periudhën nga fillimi i regjistrimit të bizneseve në vitin 1999, raporti përdor periudhën kohore prej 1 korrikut 2016 deri më 31 dhjetor 2016.


II. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE

Shoqëritë tregtare, siç përcaktohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, kërkohen të regjistrohen në zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë ose në njërin nga 28 qendrat komunale për regjistrimin e shoqërive tregtare nëpër Kosovë. Kjo pjesë e raportit matë numrin e ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

Grafiku I paraqet mesataren totale të ditëve, bazuar në regjistrimin e të gjitha formave ligjore të shoqërive tregtare, përkundër ndryshimeve të mëdha në kohën për regjistrimin e llojeve të ndryshme, p.sh., koha për regjistrimin e një biznesi individual është dukshëm më e shkurtër se koha për regjistrimin e një shoqërie aksionare.

Siç mund të shihet në Grafikon I më poshtë, për periudhën 1 korrik 2016 - 31 dhjetor 2016, numri mesatar i ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare në Kosovë ka rënë nga 1.82 në 1.65 ditë.


Grafiku I: Numri mesatar i ditëve për regjistrim të shoqërive tregtare, korrik - dhjetor 2016:



III. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHPK-VE


Si forma më e zakonshme korporative, kjo pjesë e raportit analizon kohën për regjistrim të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK). Grafiku 2 më poshtë tregon se nga data 1 korrik 2016 deri më 31 dhjetor 2016, numri mesatar i ditëve për regjistrimin e një SHPK-je në Kosovë ka zbritur nga 2.38 në 1.97 ditë, që paraqet përmirësim prej 17.23% sa i përket kohës për regjistrim të një SHPK-je gjatë kësaj periudhe.

Grafiku 2: Numri mesatar i ditëve për regjistrim të SHPK-ve, korrik - dhjetor 2016:



Për më tepër, Grafiku 3 më poshtë tregon mesataren e ditëve për regjistrimin e SHPK-ve në qendrën e regjistrimit të ARBK-së në Prishtinë. Siç shihet në Grafikon 3, numri mesatar i ditëve për regjistrimin e një SHPK-je ka zbritur nga 2.36 në 2.16 ditë, që paraqet përmirësim prej 8.47% sa i përket kohës për regjistrimin e një SHPK-je gjatë kësaj periudhe.

Grafiku 3: Numri mesatar i ditëve për regjistrim të SHPK-ve në qendrën e regjistrimit në Prishtinë, korrik - dhjetor 2016:



IV. KOHA PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS QENDRËS SË REGJISTRIMIT

Tabela I më poshtë tregon numrin mesatar të ditëve për regjistrimin e shoqërive tregtare sipas qendrave komunale të regjistrimit të shoqërive tregtare gjatë periudhës I korrik - 31 dhjetor 2016. Tabela e shfaqur përfshin 28 qendrat komunale për regjistrimin e shoqërive tregtare dhe zyrën qendrore të ARBK-së e cila gjithashtu mbulon komunën e Prishtinës dhe Obiliqit.

Ndarja sipas qendrave të regjistrimit në tabelën më poshtë është krijuar në bazë të dhënave të adresës së regjistruar të shoqërive tregtare. Nëse një shoqëri tregtare e ka adresën e regjistrimit në Gjilan, është përdorur supozimi se shoqëria tregtare është regjistruar në qendrën e regjistrimit në Gjilan, edhe pse ekziston mundësia që ajo shoqëri tregtare të jetë regjistruar në qendrën kryesore të ARBK-së në Prishtinë. Kjo është për arsye se ARBK aktualisht ka një sistem unik të regjistrimit të shoqërive tregtare i cili përfshin të dhënat për shoqëritë tregtare të regjistruara në të gjithë territorin e Kosovës, pra jo sipas qendrës së regjistrimit.

Tabela I: Numri mesatar i ditëve për regjistrimin e shoqërive tregtare sipas Qendrave për Regjistrimin e Shoqërive Tregtare, korrik - dhjetor 2016:

Qendra e Regjistrimit	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Mesatarja
Deçan	1.59	1.13	1.20	1.14	3.00	1.57	1.50
Dragash	1.22	1.20	1.00	1.00	2.00	1.00	1.15
Ferizaj	1.99	1.38	1.97	1.74	1.36	1.44	1.67
Fushë Kosovë	1.71	1.33	1.74	1.70	1.92	1.96	1.74
Gjakovë	1.62	1.35	1.33	1.36	1.19	1.11	1.36
Gjilan	1.43	1.19	1.41	1.67	1.29	1.51	1.42
Gillogoc	1.29	1.18	1.60	1.48	1.63	1.50	1.44
Graçanicë	5.00	1.00	1.50	3.00	1.88	1.80	2.17
Hani i Elezit	2.33		2.00	1.00	1.80	1.25	1.73
Istog	1.60	1.23	1.23	1.36	1.71	1.81	1.51
Kaçanik	2.50	1.10	1.38	1.30	1.40	1.60	1.55
Kamenicë	1.85	1.00	2.71	1.60	1.43	1.43	1.66
Klinë	1.40	1.18	1.21	1.64	2.63	1.36	1.51
Lipjan	1.79	1.48	1.67	2.33	1.86	1.50	1.81
Malishevë	2.60	3.69	1.31	1.00	1.17	1.20	1.92
Mitrovicë	1.51	1.14	1.38	1.43	1.42	1.31	1.39
Mitrovicë Veriore	1.38	1.44	1.30	1.31	1.47	1.85	1.45
Novobërdë	1.29	1.50	1.00	1.00	1.00	1.00	1.21
Pejë	1.51	1.17	1.24	1.24	1.16	1.33	1.28
Podujevë	1.81	1.12	1.40	1.83	1.46	1.40	1.46
Prishtinë (ARBK)	2.10	1.48	1.70	1.96	1.90	2.02	1.84
Prizren	1.70	1.30	1.28	1.42	1.34	1.18	1.38
Rahovec	1.37	1.17	2.94	1.38	1.23	1.27	1.49
Shtërpçë	2.00	3.00	1.25	1.00	2.00	1.75	1.77
Shtime	2.57	2.45	1.75	1.92	1.44	1.78	1.98
Skenderaj	1.87	1.43	1.31	1.50	1.26	1.16	1.46
Suharekë	1.75	1.37	1.40	1.86	1.38	1.64	1.59
Viti	1.89	1.13	1.24	1.53	1.20	2.14	1.53
Vushtrri	2.95	1.92	1.33	1.78	1.54	1.59	1.80
Mesatarja	1.82	1.39	1.57	1.68	1.61	1.65	1.62

*Ngjyra e kuqe paraqet mesatare të madhe të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

*Ngjyra e gjelbër paraqet mesatare të vogël të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

V. REGJISTRIMI DHE ÇREGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE

Tabela 2 më poshtë paraqet numrin e shoqërive tregtare të regjistruara dhe numrin e shoqërive tregtare të çregjistruara sipas formës ligjore të shoqërisë tregtare dhe muajit të regjistrimit për periudhën 1 korrik - 31 dhjetor 2016. Të dhënat tregojnë se forma ligjore e shoqërive tregtare më e regjistruar është Biznesi Individual, e ndjekur nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar. Forma ligjore me numrin më të madh të çregjistrimeve për periudhën korrik - dhjetor 2016 është po ashtu Biznesi Individual dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar.

Tabela 2: Numri i shoqërive tregtare të regjistruara dhe çregjistruara sipas formës ligjore, korrik - dhjetor 2016:

Regjistrimi sipas formës ligjore	Muaji	Biznes Individual	Ortakëria e Përgjithshme	Ortakëria e Kufizuar	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara	Shoqëri Aksionare	Dega e Kompanisë së Huaj	Kooperativa Bujqësore	Totali
Shoqëri Tregtare të Regjistruara	Korrik	529	3	-	251		5		788
	Gusht	539	1	-	282	3	6		831
	Shtator	490	2	-	372	1	4	1	870
	Tetor	518	2	-	338	3	4		865
	Nëntor	388	3	-	310	2	5		708
	Dhjetor	371	1	-	317	3	6	2	700
	Totali	2,835	12	0	1,870	12	30	3	4,762
Shoqëri Tregtare të Çregjistruara	Korrik	142	4	1	9	-	-	-	156
	Gusht	130	3		7	-	-	-	140
	Shtator	147	2		4	-	-	-	153
	Tetor	165	2		11	-	-	-	178
	Nëntor	144	5		13	-	-	-	162
	Dhjetor	144	3		14	-	-	-	161
	Totali	872	19	1	58	0	0	0	950

Tabela 3 paraqet gjendjen e përgjithshme ekzistuese sa i përket regjistrimit dhe çregjistrimit të shoqërive tregtare për periudhën 1999 – 2016 (31 dhjetor).

Tabela 3: Numri i shoqërive tregtare të regjistruara dhe çregjistruara sipas formës ligjore, 1999-2016:

Periudha 1999- 2016	Biznes Individual	Ortakëria e Përgjithshme	Ortakëria e Kufizuar	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara	Shoqëri Aksionare	Dega e Kompanisë së Huaj	Kooperativa Bujqësore	Totali i Shoqërive Tregtare
Shoqëritë Tregtare të Regjistruara	138,953	3,909	90	19,879	724	833	98	164,486
Shoqëritë Tregtare të Çregjistruara	13,633	368	2	532	29	76	3	14,643
Totali i Shoqërive Tregtare	125,320	3,541	88	19,347	695	757	95	149,843

VI. REGJISTRIMI I DEGËVE TË KOMPANIVE TË HUAJA SIPAS VENDIT TË ORIGINËS

Në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, kompania e huaj përkufizohet si një shoqëri tregtare që është themeluar dhe aktualisht ekziston sipas një ligji të një juridiksioni jashtë Kosovës dhe e cila mund të angazhohet në aktivitete afariste në Kosovë përmes regjistrimit të një dege në Kosovë në ARBK. Tabela 4 më poshtë tregon numrin total të degëve të kompanive të huaja të regjistruara në Kosovë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, të ndara sipas vendit të origjinës, për periudhën korrik - dhjetor 2016.

Tabela 4: Degët e kompanive të huaja të regjistruara në Kosovë sipas vendit të origjinës, korrik - dhjetor 2016:

Vendi i origjinës së kompanive të huaja	Degët e kompanive të huaja
Shqipëria	9
Zvicra	4
Turqia	4
Kroacia	3
Greqia	2
Rumunia	2
Suedia	1
Panama	1
Luksemburgu	1

Maqedonia	1
Italia	1
Holanda	1
Totali	30

VII. NUMRI I SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILAT ËSHTË I PËRFSHIRË SË PAKU NJË PRONAR, ORTAK OSE AKSIONAR I HUAJ

Të dhënat në Tabelën 5 paraqesin numrin e shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj. Gjatë periudhës korrik - dhjetor 2016 janë regjistruar gjithsej 4,732 shoqëri tregtare nga të cilat 352 kanë pasur një person të huaj fizik ose juridik si pronar, ortak ose aksionar. Nga ky numër janë përjashtuar degët e kompanive të huaja që janë paraqitur në Tabelën 4.

Tabela 5: Numri i shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj, korrik - dhjetor 2016:

Muaji	Biznes Individual	Ortakëria e Përgjithshme	Ortakëria e Kufizuar	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara	Shoqëri Aksionare	Kooperativa Bujqësore	Totali
Korrik	3		-	28		-	31
Gusht	16		-	43		-	59
Shtator	13		-	56		-	69
Tetor	13		-	49		-	62
Nëntor	20	2	-	60		-	82
Dhjetor	7		-	41	1	-	49
Totali	72	2	0	277	1	0	352

*Këto të dhëna nuk paragjykojnë përqindjen e kapitalit të personave të huaj. Qëllimi i kësaj tabele është paraqitja e pjesëmarrjes së personave të huaj si pronarë, ortakë ose aksionarë në shoqëri tregtare në Kosovë.

*Nga kjo tabelë është përjashtuar numri i "Degëve të Kompanive të Huaja" që është paraqitur në Tabelën 4.


Nga 4,732 shoqëri tregtare të regjistruara gjatë kësaj periudhe në Kosovë, numri total i personave të huaj si pronarë, ortakë ose aksionarë është 493. Siç mund të shihet në Tabelën 5, forma ligjore e shoqërive tregtare më e regjistruar në mesin e personave të huaj është Biznesi Individual dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuara. Gjithashtu, në Tabelën 4, ju mund të shihni numrin total të degëve të kompanive të huaja të regjistruara gjatë kësaj periudhe, i cili është 30.

VIII. REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË

Të dhënat në Grafikon 4 dhe 5 paraqesin pjesëmarrjen gjinore në shoqëritë tregtare të regjistruara gjatë periudhës I korrik - 31 dhjetor 2016. Për shkak të natyrës të formave të ndryshme ligjore të shoqërive tregtare, të dhënat paraqiten ndaras për Bizneset Individuale, të cilat kanë pronar të vetëm dhe janë zakonisht biznese të vogla, dhe ndaras për format ligjore të tjera të shoqërive tregtare ku pronarët marrin pjesë si ortakë apo aksionarë në shoqëri tregtare më të mëdha ose më diverse.


Si forma më e zakonshme e shoqërisë tregtare në Kosovë, Grafiku 4 më poshtë matë përqindjen e pronarëve femra dhe meshkuj në Biznese Individuale.

Grafiku 4: Përqindja e Bizneseve Individuale sipas Gjinisë, korrik - dhjetor 2016:



Grafiku 5 reflekton përqindjen e ortakëve ose aksionarëve të shoqërive tregtare sipas gjinisë të regjistruar, me përjashtim të bizneseve individuale dhe degëve të kompanive të huaj.

Grafiku 5: Përqindja e Ortakëve dhe Aksionarëve sipas Gjinisë, korrik - dhjetor 2016:



IX. PËRFUNDIM

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në mënyrë që të përmirësoj akoma më shumë efikasitetin e regjistrimit në ARBK ka ndërmarrë një sërë veprimesh:

- Ka iniciuar zhvillimin, institucionalizimin dhe përdorimin e rregullt të matjeve të performancës duke nxjerrë nga të dhënat zyrtare të regjistrimit për të monitoruar kohën për përpunimin e aplikacioneve për regjistrim nëpër qendrat komunale të regjistrimit dhe për të identifikuar performuesit më të mirë si dhe ata më të përmirësuarit;
- Ka rritur fokusin në sigurimin e pajtueshmërisë me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
- Ka thelluar koordinimin ndërmjet Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës për të përmirësuar kohën e procesit të regjistrimit të aplikacioneve dhe lëshimin e numrave identifikues tatimor në qendrat e regjistrimit të ARBK-së, duke përfshirë zhvillimin dhe ekzekutimin e një Memorandumi formal të Mirëkuptimit ndërmjet ARBK-së, ATK-së dhe Ministrisë së Administratës Publike për bashkëpunim më të thellë dhe të vazhdueshëm në Qershor të vitit 2016. Sistemet e ARBK-së dhe ATK-së janë integruar, dhe
- Ka zhvilluar programe trajnimi gjithëpërfshirëse për shërbimin ndaj klientëve me të gjithë stafin e ARBK-së dhe të qendrave komunale të regjistrimit të shoqërive tregtare.

Metodologjia e përdorur për zhvillimin e këtij raporti përsëritet nga ARBK dhe publikimi i raporteve të rregullta të matjes së performancës të përgatitura dhe publikuara nga ARBK shërbejnë si mjet informues për përmirësimet e mëtutjeshme të procesit. Projekti i USAID-it Partneritetet për Zhvillim do të vazhdojë të përkrahë këtë qasje deri në institucionalizimin e plotë.

FAKTE TË SHPEJTA LIDHUR ME REGJISTRIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË

Më poshtë mund të gjeni një përmbledhje të shpejtë të të dhënave të paraqitura në raportin “Indikatorët Bazë të Performancës për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë” për periudhën korrik – dhjetor 2016.

Ky raport dhe kjo përmbledhje janë përgatitur nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) dhe Projektit të USAID-it Partneritetet për Zhvillim. Këto të dhëna paraqesin shifra të ndryshme, duke filluar nga mesatarja e ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare e deri tek numri i shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një person i huaj si pronar, ortak ose aksionar.

PËRMBLEDHJE PËR PERIUDHËN KORRIK – DHJETOR 2016



PËRMBLEDHJE PËR PERIUDHËN 1999 – DHJETOR 2016

